

Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë+ për Biznesin



Dokument mbi Informacionin e Produktit të Sigurimit (IPID)

Paketa: Sigurimi i Mbrojtjes së Kredisë+ për Biznesin

Shoqëria e Sigurimit: SIGAL LIFE INSURANCE GROUP Sh.a. (50% – Leader) Licenca AMF Nr. 11/2004, datë 22.06.2012.
Shoqëria e Sigurimit: Albsig Jetë sh.a 50% Licenca AMF Nr. 171 datë 13.09.2019.
IutePay Sh.p.k. – Agjent Sigurimi Licenca AMF Nr. 1922/1, datë 24.11.2023

Ky dokument jep një përmbledhje të informacionit më të rëndësishëm, që lidhet me këtë produkt. I gjithë informacioni para-kontraktor dhe kontraktor për këtë produkt është i disponueshëm dhe mund të shkarkohet në faqen zyrtare të internetit. Kliko [këtu](#) për përmbledhjen e informacionit. Për të qenë plotësisht i informuar, ju lutemi lexo me kujdes këto dokumente.

Çfarë është ky lloj sigurimi?

Ky është një produkt vullnetar sigurimi Jete dhe Aksidenti në grup, i destinuar për kredimarrësit e biznesit pranë IUTE CREDIT ALBANIA Sh.a. Produkti mbron financiarisht kredimarrësin dhe familjen e tij duke siguruar shlyerjen e kredisë aktive në rast ngjarjesh të papritura që cenojnë aftësinë për punë ose jetën.

Ky produkt nuk përbën detyrim për marrjen e kredisë, por është tërësisht në vullnetin e kredimarrësit.

Ky produkt i dedikohet pronarëve kryesorë të bizneseve mikro dhe personave fizikë të vetëpunësuar, kredimarrës aktiv pranë IUTE CREDIT ALBANIA, moshë 18–65 vjeç, rezidentë në Shqipëri. Shuma maksimale e sigurimit: ALL 3,000,000.



Çfarë mbulohet?

- ✓ Humbje e Jetës nga Shkaqe Natyrore – pagesa e shumës së papaguar të huasë ($\leq$ ALL 3,000,000)
- ✓ Humbje Aksidentale e Jetës – pagesa e shumës së papaguar të huasë ($\leq$ ALL 3,000,000)
- ✓ Paaftësi e Plotë e Përhershme (PPT $\geq$ 70%) nga aksidenti – pagesa e shumës së papaguar të huasë ($\leq$ ALL 3,000,000)
- ✓ Paaftësi e Përkohshme për Punë – pagesë e kësteve mujore (maks. 6 këste), pas 30 ditë periudhe pritjeje
- ✓ Hospitalizim (min. 7 ditë rresht) – 1/30 e kështit mujor/ditë (maks. ekuivalent 6 këste)
- ✓ Zbritje deri 50% të faturës pranë klinikave private partnere (Aneksi E) – aktive menjëherë
- ✓ Mbulim botëror (jashtë SHBA dhe Kanadasë) për të gjitha ngjarjet e siguruara



Ku jam i mbuluar?

TERRITORI	MBULIMI
Botëror (jashtë SHBA & Kanadasë)	✓ I PLOTË
SHBA dhe Kanada	✗ I PËRJASHTUAR
Klinika private partnere – zbritje (Aneksi E)	✓ Vetëm Shqipëri

Në rast dëmi kontaktoni në linkun e dedikuar [këtu](#).



Cilat raste nuk mbulohen?

- ✗ Sëmundje para-ekzistuese të njohura para datës së sigurimit
- ✗ Vetëvrasja, tentativa e vetëvrasjes dhe dëmtimi i qëllimshëm i vetes
- ✗ Luftime (të shpallura ose jo), trazira, veprime armike, lufta civile
- ✗ Rrezatimi bërthamor, kontaminimi radioaktiv, biologjik ose kimik
- ✗ Ndikimi i alkoolit, drogave ose ilaçeve të paprescriptuara si shkak kontribues i ngjarjes
- ✗ AIDS dhe sëmundjet e lidhura me të
- ✗ Sporti ekstrem (parashutizëm, alpinizëm teknik, gara motorike, zhytje, aeronautikë amatore)
- ✗ Aksidente gjatë drejtimit të mjeteve motorike pa leje drejtimi të vlefshme
- ✗ Trajtime kozmetike/estetike ose elektive të panevojshme mjekësisht
- ✗ Deklarime të rreme, mashtrim ose fshehje e informacionit material
- ✗ Sanksione ekonomike dhe embargo ndërkombëtare (KB, BE, SHBA)
- ✗ Ngjarje jashtë territorit të mbuluar (SHBA dhe Kanada janë të përjashtuara)



A ka kufizime në mbulim? KRITERET E PRANIMIT

- ! Moshë në datën e disbursimit 18–65 vjeç. Mbulimi pushon automatikisht me 65 vjeç.
- ! Rezident në Republikën e Shqipërisë.
- ! Huaja aktive. Kredi aktive e disbursuar pranë IUTE CREDIT ALBANIA.
- ! Gjendja shëndetësore (kriterë negativë). Nuk pranohen individë me alkoolizëm, narkotizëm, sëmundje mendore aktive, nevojë për kujdes të përhershëm.
- ! Bashkë-kredimarrësit nuk sigurohen; vetëm kredimarrësi kryesor (pronari i biznesit >50% ose i vetëpunësuar).
- ! PPT – periudha 12-mujore vlerësimi. Nuk është periudhë pritjeje, por periudhë e nevojshme mjekësore për vlerësimin e pakthyeshmërisë (KMCA/KEMP).
- ! Paaftësi e Përkohshme – periudha e pritjes. 30 ditë kalendarike nga fillimi i sigurimit.
- ! Shuma maksimale e sigurimit. ALL 3,000,000 ose ekuivalent. Limit kumulativ i të gjitha pagesave.
- ! Rimbursim primi - Vetëm nëse kredia kthehet brenda 14 ditëve nga disbursimi.



Cilat janë detyrimet e mia?

- Dhënie e informacionit të saktë, të plotë dhe të vërtetë gjatë aplikimit dhe gjatë gjithë periudhës.
- Njoftim me shkrim ndaj Policëmbajtësit brenda 30 ditëve kalendarike nga ndodhja e ngjarjes.
- Dorëzim i dokumentacionit të plotë sipas llojit të ngjarjes (shih Seksionin 7).
- Bashkëpunim i plotë me Bashkësiguruesin gjatë procesit të hetimit dhe trajtimit të dëmit.
- Njoftim i menjëhershëm për çdo ndryshim material (gjendje shëndetësore, statusi i huasë).
- Pagesa e primit të sigurimit brenda afateve (single premium me disbursimin e huasë).



Kur dhe si të paraqes pretendimin e dëmit?

Si të njoftoni një dëm:

- Nëpërmjet portalit online të dedikuar në linkun [këtu](#).
- Duke paraqitur dokumentacionin e plotë pranë degëve partnere të IUTE CREDIT ALBANIA. Afati i njoftimit: brenda 30 ditëve kalendarike nga ndodhja e ngjarjes ose nga data kur keni marrë dijeni.

Dokumentet bazë të kërkuara (të gjitha ngjarjet):

- Certifikata e Sigurimit;
- Dokumenti i identifikimit (ID ose Pasaportë);
- Kopja e kontratës së kredisë dhe tabela e amortizimit;
- Vërtetëse bankare mbi shumën e papaguar të huasë në datën e ngjarjes.

Dokumentet shtesë sipas llojit të ngjarjes (shih Kushtet e Përgjithshme, Seksioni 11):

Humbje Jete Natyrore:

1.Certifikatë vdekjeje 2.Epikriza mjekësore 3.Skeda e vdekjes.

Humbje Aksidentale:

1.Certifikatë vdekjeje 2.Ekspertim mjeko-ligjor 3.Raport policor 4.Vendim Prokurorie.

PPT: 1.Vendim KMCA (≥70%) 2.Procesverbal Polici 3.Dokumentacion shtesë.

Paaftësi e Përkohshme / Hospitalizim:

1.Raport mjekësor 2.Raport shtrimi/lëshimi 3.Vërtetim punëdhënësi.



Kur dhe si paguaj?

- Mënyra e pagesës: Prim i vetëm, i paguar njëherësh (single premium) gjatë disbursimit të huasë.



Kur fillon dhe kur mbaron mbulimi me sigurim?

- Mbulimi fillon në datën e shënuar në Certifikatën e Sigurimit, me kusht që të jetë paguar primi i sigurimit.
- Mbulimi përfundon kur:
- WūèièèšÇTèiçÇjŃČsŔjŁTèššÇTèèŔŁiçÇjŃČsŔèšèiijŁÇÇ|
- Ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe është përfituar maksimumi i lejuar sipas kësaj police.
- Nuk jeton kryen aktivitet në Republikën e Shqipërisë.



Si mund ta anuloj kontratën?

- Klienti mund të kërkojë anulim vullnetar me shkrim pranë IUTE CREDIT ose SIGAL LIFE.
- Rimbursim i primit: Vetëm nëse anulimi bëhet brenda periudhës 14-ditore nga hyrja në fuqi e sigurimit. Pas kësaj date, primi nuk rimbursohet, por rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni i zbatueshem ose kushtet e polices.



VËREJTJE: Ky dokument IPID ofron vetëm një përmbledhje të produktit të sigurimit. Informacioni i plotë mbi kushtet e mbulimit, përjashtimet, procedurën e dëmit dhe të drejtat tuaja ndodhet tek Kushtet e Përgjithshme të Sigurimit, Certifikata e Sigurimit dhe dokumentet kontraktore. Ju lutemi lexoni me kujdes të gjithë dokumentacionin para nënshkrimit.

ANKESA DHE MOSMARRËVESHJET: Çdo ankesë mund të paraqitet pranë SIGAL LIFE me shkrim. Nëse nuk jeni të kënaqur me trajtimin, keni të drejtë t'i drejtoheni Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), adresa: Rruga "Ismail Qemali" Nr. 27, Tiranë.

KONTAKTI:

SIGAL LIFE INSURANCE GROUP Sh.a. | Tel: +355 4 2233 093 | www.sigal.al — ALBSIG JETE Sh.A. | www.albsig.al